



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.20.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ADMINISTRATËS TATIMORE
TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Administratës Tatimore të Kosovës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Jusuf Kryeziu (Udhëheqës Ekipi), Besa Morina, Saranda Husaj dhe Fatlinda Podvorica (Anëtarë Ekipi).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) të sektorit publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 25/9/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm - auditimi 2015

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Administrata Tatimore të Kosovës dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i Administratës Tatimore të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarim materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

ATK duhet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr.04/L-116 dhe Ligjin nr.04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të buxhetit 2015;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për borxhet e papaguara; dhe
- Planin preliminar dhe final të prokurimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23/11/2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti. Në draft Pasqyrat Financiare ishin të nevojshme të bëhen korrigjime financiare të cilat janë marrë parasysh nga menaxhmenti i ATK-së.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ATK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve dhe të hyrave (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i ATK-së. Ky është një tregues që ATK ka bërë përpjekje t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe të instaloj një qeverisje efektive. Megjithatë, disa rekomandime mbesin të pa implementuara dhe për pasojë mangësi të njëjta përsëriten çdo vit. Me theks të veçantë, rekomandimet lidhur me të arkëtueshmet dhe menaxhimin e rimbursimeve.

Aranzhimet ekzistuese të qeverisjes në ATK janë efektive. Plani strategjik 2015-2020, Strategjia e Përbushjes 2012-2015 dhe Regjistri i menaxhimit të rreziqeve i përgatitur në baza vjetore janë tregues që ATK ka instaluar mekanizma për qeverisje efektive. Megjithatë, për të mbështetur funksionimin e këtyre mekanizmave, ATK duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave. Edhe pse, proceset e monitorimit të rregullt lidhur me progresin e arritjes së

objektivave konsiderohen si të vendosura, mirëpo dëshmitë për mbështetjen e konkluzioneve në lidhje me to duhet të avancohen më tutje..

Më tutje, NjAB si hallk kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur vlerësimin e kontrolleve të brendshme në ATK.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014, ka rezultuar me 17 rekomandime. ATK ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, tetë (8) rekomandime janë adresuar plotësisht, tri (3) pjesërisht, përderisa gjashtë (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	Përkundër progresit në implementimin e rekomandimeve të AP-së, ATK duhet të vazhdoj të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për adresimin e plotë të tyre. Si pasojë, mangësitë e njëjta janë përsëritur në fushën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për kapitale, menaxhimit të pasurisë, rimbursimet si dhe menaxhimin dhe inkasimin e të arkëtueshmeve.
Rreziku	Mos implementimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të dobësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve apo edhe humbje financiare.
Rekomandimi 1	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP për vitin e kaluar.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ATK-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. ATK në mënyrë të vazhdueshme monitoron arritjen e objektivave të përcaktuara. Megjithatë, procesi ekzistues i monitorimit duhet të dokumentohet përmes një plani të veçantë të veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave.

Rreziku Mungesa e planit të veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave shkakton paqartësi rreth synimeve të organizatës.

Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të avancoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave të organizatës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit operon ATK, dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet që të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Dispozitat e LMFP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyqe të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

ATK ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, duke e hartuar planin detaj për trajtimin e rreziqeve të organizatës.

2.5.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

ATK ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi e cila është në përbërje të Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe tre auditorëve.

NjAB është funksionale dhe ka operuar në bazë të planit dhe përgjegjësi të caktuara. NjAB ka një plan vjetor të auditimit për 2015, në bazë të të cilit ka paraparë kryerjen e nëntë (9) auditimeve të rregullta dhe auditime sipas kërkesës. Në këtë plan është paraparë edhe përcjellja e implementimit të rekomandimeve. Deri në fund të vitit 2015, kjo njësi ka hartuar gjithsej dhjetë (10) raporte të auditimit, prej tyre një (1) ishte vazhdimësi e auditimeve për periudhën 2014.

Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB-së janë cilësore dhe menaxhmentit i kishin ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

Çështja 3 – Përfaqësuesi i ATK-së në komitetin e auditimit – Prioritet i lartë

E gjetura	Komiteti i Auditimit (KA) është i themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave si trup i përbashkët i sistemit të auditimit. ATK përfaqësohet në këtë komitet me anë të një anëtari (përfaqësuesi), i njëjti është pensionuar me datën 12.10.2015 dhe ende ATK nuk e ka zëvendësuar këtë pozitë (përfaqësues). Gjatë vitit 2015, në tri takime të mbajtura nga ky komitet janë diskutuar të gjeturat dhe implementimi i rekomandimeve të ATK-së.
Rreziku	Mungesa e përfaqësimit dhe raportimit në komitet të auditimit, e rrit rrezikun që të gjeturat dhe rekomandimet e nxjerra për ATK-në të mos trajtohen në nivelin e duhur.
Rekomandimi 3	Drejtori i Përgjithshëm duhet të caktoj një përfaqësues në komitetin e auditimit, në mënyrë që të sigurohet për diskutimin e të gjeturave dhe implementimin e rekomandimeve të ATK-së.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, të hyrave, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë, të arkëtueshmet dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë relativisht të mira. ATK ka arritur të realizoj 99% të buxhetit final për vitin 2015. Megjithatë, edhe më tutje nevojitet përmirësim i procesit buxhetor në kategorinë e investimeve kapitale. Kjo për arsye, se buxheti për këtë kategori për vitin 2015 është shpenzuar rreth 65%.

Më tutje, performanca e mbledhjes së të hyrave në ATK krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar në vitin 2015. Në raport me vitin 2014 kishte realizim më të lartë të të hyrave neto për 31,420,358€ apo shprehur në përqindje 11.5% rritje. E vlen të cekët që, ATK vite me radhë nuk ka arritur ta përmbush planin vjetor të të hyrave. Marrë parasysh këtë, plani i të hyrave për vitin 2015 është rishikuar dhe pas rishikimit ky plan është reduktuar për përafërsisht 90 milion€. Auditimi ynë i këtij viti nuk ka nxjerr në pah mangësi domethënëse në fushën e të hyrave, në përjashtim të disa çështjeve specifike.

Po ashtu, auditimi ynë i këtij viti nuk ka identifikuar ndonjë mangësi domethënëse në menaxhimin e shpenzimeve për mallra dhe shpenzime dhe për paga dhe mëditje, në përjashtim të disa çështjeve.

Megjithatë, të hyrat e pa arkëtuara kërkojnë vëmendjen e menaxhmentit të ATK-së për të siguruar se do të shtohet efikasiteti në menaxhimin dhe inkasimin e tyre. Kjo për faktin që, llogaritë e arkëtueshme në vitin 2015 krahasuar me 2014 janë rritur për 67%.

Në këtë aspekt, inkurajojmë menaxhmentin e ATK-së të marr në konsideratë përfitimin nga puna e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për të ngritur nivelin e kontrolleve në fushat me mangësi të theksuara.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ATK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	7,614,697	8,146,976	8,079,103	8,081,656	7,616,788
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,614,697	8,146,976	8,079,103	8,081,656	7,616,788

Buxheti final ishte më i madh se buxheti fillestar për 532,279€. Sqarimet lidhur me ndryshimet në buxhetin final të ATK-së janë dhënë poshtë tabelës 2.

Në vitin 2015, ATK ka realizuar rreth 99% të buxhetit final. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit për vitin 2015 mbetet në nivel të kënaqshëm.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,614,697	8,146,976	8,079,103	8,081,656	7,616,788
Pagat dhe Mëditjet	6,132,925	6,578,469	6,585,102	6,151,283	5,385,023
Mallrat dhe Shërbimet	1,268,200	1,219,935	1,196,993	1,253,266	1,571,764
Shërbimet komunale	168,572	203,572	202,898	202,361	229,676
Investimet Kapitale	45,000	145,000	94,110	474,746	430,325

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është rritur për 445,544.00€. Përderisa i njëjti nuk ka mjaftuar për mbulimin e kësaj kategorie për vitin 2015. Financimi i diferencës për paga dhe mëditje është bërë nga programet tjera të MF-së . Buxheti për këtë kategori për 2015 është shpenzuar 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 48,265€. Zvogëlimi është bërë me vendim të Qeverisë. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 98%.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

- Buxheti final për komunal në raport me buxhetin fillestar është rritur për 35,000€. Buxheti final është shpenzuar rreth 100%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 100,000€. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar rreth 65% i cili është në nivel jo të kënaqshëm.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat	429,600,000	340,000,000	332,772,486	303,694,991	305,447,912
Kthimet	(41,300,000)	(39,200,000)	(28,765,220)	(31,108,083)	(34,684,540)
Totali	388,300,000	300,800,000	304,007,266	272,586,908	270,763,372

Plani final i të hyrave bruto në raport me planin fillestar me rishikim të buxhetit është zvogëluar për 89,600,000€. Plani final i të hyrave bruto është realizuar rreth 98%.

Nga trendi i të hyrave në ATK vërehet se ka një ngritje të të hyrave neto në raport me vitin paraprakë për 31,420,358 €, apo shprehur në përqindje rreth 11.5% rritje.

Çështja 4 – Realizimi i buxhetit për investimet kapitale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Edhe pse në përgjithësi ishte një nivel i mirë i realizimit të buxhetit, realizimi i buxhetit në investime kapitale prej 94,110€ mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Një ndër shkaqet e mos realizimit ishte edhe nënshkrimi i kontratave për katër (4) projekte kapitale në dy mujorin e fundit të 2015.
- Rreziku** Realizimi i buxhetit në nivelin jo të pritur dhe mos përmbushja e planit në investime kapitale mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe uljen e efikasitetit të ATK-së.
- Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen.

Çështja 5 - Pagesa e pagave nga programet e tjera të MF-së - Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe pse këtë vit kishte progres krahasuar me vitet e kaluara, buxheti i aprovuar për këtë kategori vazhdon të mbetet nën kërkesat reale të ATK-së.
- Si pasoj e kësaj, ATK kishte mungesë të mjeteve për paga dhe mëditje në vlerë prej 6,633€, dhe kjo mungesë e buxhetit është financuar nga një program tjetër i MF-së.
- Rreziku** Mungesa e buxhetit mund të shkaktoj ngecje në realizimin e objektivave të ATK-së dhe mund të shkaktoj obligime të pagave për të punësuarit.
- Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të vazhdojë diskutimet me Ministrin e Financave për të siguruar që buxheti për vitet e ardhshme aprovohet në bazë të kërkesave reale të dorëzuara nga ATK me qëllim që financimi i pagave të bëhet në mënyrë transparente.

3.4 Të Hyrat

Të hyrat bruto të gjeneruara nga ATK në vitin 2015 ishin në total 332,772,486€, përderisa kthimet ishin 28,765,220€. Si rezultat i kësaj të hyrat neto të realizuara nga ATK për vitin 2015 janë 304,007,226€. Në raport me vitin e kaluar, ATK ka shënuar realizim më të lartë të të hyrave për 31,420,358€, apo rreth 11.5%. Rritje më të madhe tregohet tek tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi i pagave i mbajtur në burim dhe tatimi për korporata. Në vijim do të paraqesim në mënyrë të detajuar të hyrat dhe kthimet për vitin 2015.

Tabela. 4 të hyrat e detajuara sipas llojit dhe kthimet (Janar-Dhjetor/2015).

Nr.	Përshkrimi	Vlera në Euro (€)
1	Kompensimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve	4,880
2	Konto kaluese - administrata tatimore	8,332
3	Licencat për lojëra	60,000
4	Tatim mbajtur burim, interesa, drejta pronësore dhe qira	6,361,503
5	Tatim mbi qira, pasuri patrupëzuar	1,540,429
6	Tatimi i pagave i mbajtur në burim	71,716,316
7	Tatimi I paragjykuar	5,957
8	Tatimi mbi vlerën e shtuar	153,962,445
9	Tatimi në fitim	1,106
10	Tatimi për biznese individuale	29,058,601
11	Tatimi për korporata	67,652,542
12	Të hyrat nga shitja e mbeturinave	240
13	Te hyrat nga shitja mallrave të konfiskuara	2,567
14	Të hyrat nga gjobat e administratës tatimore të Kosovës	1,579,358
15	TVSH-ja e shtyrë	818,211
16	Kthimi i tatimit mbi vlerën e shtuar	(27,134,588)
17	Kthim-qira fitim loto drejt	(1,602)
18	Kthim-tatimi I paragjykuar	(71,670)
19	Kthim-tatimi per biznese	(100,202)
20	Kthim-tatimi per korporata	(1,369,001)
21	Kthim-tax ne paga - mbajt.burim	(82,554)
22	Kthim-te hyrat-gjobat e ATK-se	(5,604)
Të Hyrat Neto		304,007,266

Ne kemi ekzaminuar 100 mostra (teste thelbësore), kryesisht në të hyrat nga: Tatimi mbi vlerën e shtuar, Tatimi për korporata, Tatimi për biznese individuale, Tatimi i pagave i mbajtur në burim dhe Tatimi mbi qira, si dhe kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për disa mostra. Përveç kësaj,

kemi ekzaminuar kthimet e tatimit mbi vlerën e shtuar. ATK në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave, përveç disa mangësive të cilat janë të prezantuara në vijim:

Çështja 6 - Mos harmonizimi i të dhënave dhe vonesa në rimbursim - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi analizuar rimbursimet për vitin 2015, ku kërkesat nga tatimpaguesit për rimbursime ishin 30,131,630€. Si rezultat i shqyrtimit të këtyre kërkesave nga ATK, ishin refuzuar kërkesa në vlerë prej 391,595€ përderisa ishin aprovuar kërkesa në vlerë prej 29,740,034€. Nga vlera e aprovuar 29,740,034€ janë transferuar në llogarit e tatimpaguesve të cilët kanë parashtruar kërkesën për rimbursim kurse pjesa tjetër 1,855,151€ është ndaluar në emër të obligimeve të cilat të njëjtit tatimpagues i kishin ndaj ATK-së. Mirëpo sipas të dhënave të Thesarit, rimbursimet e tatimeve janë në vlerë prej 28,765,220€. Pra, vlera e rimbursimeve sipas të dhënave të ATK-së është më e lartë se në Thesar. Kjo mangësi ka qenë e evidente edhe vitet e kaluara.

Rreziku Ndryshimet në informata mes Thesarit dhe ATK-së vënë në dyshim besueshmërinë e të dhënave të raportuara.

Rekomandimi 6 Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj masat për identifikimin e shkaktarëve për të dhënat jo konsistente dhe eliminimin e tyre në mënyrë që të sigurohet harmonizimi i të dhënave lidhur me rimbursimet.

Çështja 7 - Vonesa në rishqyrtimin e rimbursimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 30 pika 4, ATK duhet të veprojë lidhur me kërkesën e aprovuar për rimbursim brenda 60 ditëve nga data kur ka pranuar kërkesën nga tatimpaguesi. Nëse rimbursimi nuk zbatohet brenda periudhës kohore, atëherë ATK përveç rimbursimit, tatimpaguesit duhet t'ia paguaj edhe interesin.

Nga gjithsej 13 raste të ekzaminuara për rimbursim, në pesë (5) prej tyre kemi vërejtur se kishte vonesë në rishqyrtim të rimbursimit.

Rreziku Vonesat në rimbursime ndikojnë në efikasitetin e zbatimit të legjislacionit dhe mund të rezultojë me pagesa të interesit nga ana e ATK-së ndaj tatimpaguesit.

Rekomandimi 7 Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që kërkesa e tatimpaguesve të aprovuara për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor.

3.5 Prokurimi

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Shpenzimet totale të ATK-së përmes procedurave të prokurimit janë në vlerë prej 1,205,932€.

Në përgjithësi në ATK kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efektive, megjithatë janë disa mangësi të cilat duhet të adresohen për ta përmirësuar procesin në tërësi.

Çështja 8 - Njoftimi në KRPP jo brenda afatit të kërkuar ligjor - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Për aktivitetin e prokurimit "Publikimi i njoftimeve në shtypin ditor sipas kërkesave dhe nevoja të ATK-së" me vlerë të parashikuar prej 20,000€, ATK ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Megjithatë, njoftimi në KRPP për përdorim të kësaj procedure nuk është bërë brenda afatit. Data e njoftimit të KRPP-së mban të njëjtën datë të raportit për vlerësim të ofertave të bërë nga komisioni vlerësues.
- Rreziku** Mos respektimi i afateve në përdorimin e procedurave gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit tregon për mos pajtueshmëri ligjore dhe dëmton transparencën.
- Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se në rastet e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të bëhet njoftimi në KRPP brenda afateve ligjore.

3.6 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.6.1 Vendimet gjyqësore

Në vitin 2015, ATK ka realizuar shpenzime përmes procedurave gjyqësore në vlerë prej 6,999€. Prej tyre kemi ekzaminuar tri (3) mostra (raste), dhe si rezultat i ekzaminimit të këtyre mostrave doli që:

Çështja 9 –Vendimet e gjykatës - Prioritet i lartë

E gjetura Mos përmbushja e detyrimit ligjor në mënyrë të vullnetshme që ka rrjedh nga Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovë. Sipas Aktgjykimit të datës 11 shkurt 2015 nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, ATK-ja detyrohet t'i përmbushë gjitha obligimet ndaj paditësit (punëtor i ATK-së), të parapara me kontratë të punës të lidhur me 21.02.2004 dhe atë nga ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 30.08.2006 deri në skadimin e kontratës me 31.12.2006. Obligimi duhej të përmbushej në afat prej 7 ditësh nga dita e plotë fuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

ATK, nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor në mënyrë të vullnetshme. Ky vendim është ekzekutuar nga Thesari në MF përmes transferimit të mjeteve, në vlerë prej 3,286€. Vetëm shpenzime të procedurës përbarimore janë në vlerë prej 891€. Ne nuk kemi pranuar ndonjë arsyetim për mos përmbushjen e këtij detyrimi nga vet ATK.

Rreziku Mos përmbushja e detyrimeve ligjore në kohë, rritë detyrimet e entitetit dhe dëmton performancën e saj në respektimin e ligjit.

Rekomandimi 9 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

3.6.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në ATK kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një analizim i variancave dhe harmonizimeve të ndryshme. Numri i punëtorëve të planifikuar ishte 785 ndërsa numri i punëtorëve në fund të vitit 2015 ishte 776.

Nga testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

Çështja 10 - Mospërputhje në mes të koeficienti në akt emërim me koeficientin në payroll - Prioritet i lartë

E gjetura Në shtatë (7) raste, kemi vërejtur se kategoria funksionale (koeficienti), në aktemërim nuk ishte në përputhje me koeficientin dhe pagën e të punësuarit në payroll. Sipas zyrtarëve të ATK-së janë 47 raste të njëjta, ku koeficienti në kontratë nuk përputhet me pagat të cilat i marrin aktualisht këta punëtorë.

Kjo ka ardhur si rezultat i avancimit të stafit për gjysmë koeficienti në maj të vitit 2014, dhe kjo gjendje ka vazhduar deri në muajin qershor 2015 ku me rishikim të buxhetit janë realizuar këto kontrata.

Në korrik 2015, ATK ka harmonizuar akt emërimet me koeficientet në payroll.

Rreziku Mangësitë e paraqitura në aktemërimet dhe kompensim të punonjësve mund të humbin besueshmërinë ndaj kontrolleve në ATK.

Rekomandimi 10 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha të dhënat në aktet e emërimit azhurnohen me kohë.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 2,011,841€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 248,724€ si dhe stoqet në vlerë prej 147,295€.

Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja 11 – Mangësi në menaxhimin e pasurive të ATK-së – Prioritet i lartë

E gjetura ATK e ka formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë i cili e ka kryer inventarizimin dhe ka përgatitur raportin e inventarizimit. Mirëpo, nuk ka formuar komisionin për vlerësim të pasurisë i cili duhej kryer detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht nuk është bërë vlerësimi i pasurisë.

Sipas rregullores për menaxhimin e pasurive, çdo organizatë buxhetore duhet mbajë regjistrin E-pasuria, për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€. ATK nuk ka funksionalizuar regjistrin E-pasuria, mirëpo ka një softuer të brendshme për evidentimin e pasurisë.

Sipas rregullës së MF-së, nr.02/2013, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes. Mirëpo, në 12 mostra të testuara është aplikuar zhvlerësimi edhe për muajin e blerjes.

Rreziku Mungesa e vlerësimit të pasurisë, përdorimi i sistemit tjetër në vend të e-pasuria si dhe zhvlerësimi i pasurisë për muajin e parë të blerjes rrisin rrezikun ndaj humbjeve të pasurisë apo keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 11 Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqpërdorimi.

3.7.2 Detyrimet e papaguara

Përshkrim

ATK, ka shpalosur obligimet e papaguara në PVF-të për vitin 2015 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore. Vlera e obligimeve të shpalosura është 541€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. ATK ka treguar progres në menaxhimin e faturave të papaguar, përderisa në fund të vitit 2014 obligimet e papaguara kanë qenë në vlerë prej 40,022€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Sipas PVF-ve 2015, ATK ka shuma të hyrave të pa arkëtuara në vlerë prej 463,196,881€. Përderisa, në fund të 2014 ishin 277,823,490€.

Përveç kësaj, në shtator 2015 është aplikuar programi për faljen e borxhit publik, i cili është në vazhdimësi prej 02 shtator 2015 deri më 02 shtator 2016. Në përputhje me ligjin për faljen e borxheve, ATK e ka nxjerrë listën për faljen e borxheve. Në vitin 2015 janë falur borxhe në vlerë prej 16,943,796€.

Si rezultat i analizimit dhe ekzaminimit të borxheve doli që:

Çështja 12 - Rritja e të arkëtueshmëve nga viti në vit - Prioritet i lartë

E gjetura Edhe më tej, trajtimi i borxheve të vjetra dhe trendi i rritjes së borxheve të reja mbetet sfidë për ATK-në. Në krahasim me vitin 2014, borxhet në vitin 2015 janë rritur për 185,373,391€. Sipas zyrtarëve të ATK-së, këtë diferencë e përbën rritja e llogarive të arkëtueshme të vitit 2015 dhe borxheve pasive të viteve të mëhershme të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në PVF të viteve të kaluara.

Rreziku Borxhet e pa arkëtuara zvogëlojnë aftësinë e ATK-së në arkëtimin e tyre si dhe krijojnë rast precedent për debitorët e tjerë të cilët mund të vendosin të mos paguajnë.

Rekomandimi 12 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e parasë publike.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarim materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarim materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarim materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarim materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarim materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarim të, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarim të, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarim materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
3 Rekomandimet e vitit paraprak	<p>Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se masat e përcaktuara në planin e veprimit për fushat me mangësi të theksuara rishikohen dhe monitorohen në vazhdimësi për të siguruar që ato zbatohen plotësisht nga stafi llogaridhënës gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme.</p>		Përkundër progresit në implementimin e rekomandimeve të AP-së, mangësi të njëjta janë prezentë në fushën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për kapitale, menaxhimit të pasurisë si dhe menaxhimin e të arkëtueshmeve.	
4.1 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit	<p>Çështja 2 – Realizimi i buxhetit për investimet kapitale – Prioriteti i Lartë</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen.</p> <p>Çështja 3 - Pagesa e pagave nga programet e tjera të MF-së - Prioritet i lartë</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të inicioj diskutimet me Ministrin e Financave për të siguruar që buxheti për vitet e ardhshme aprovohet në bazë të kërkesave reale të dorëzuara nga ATK me qëllim që financimi i pagave të bëhet në mënyrë transparente.</p>		Pjesërisht	Jo

<p>4.2 Të hyrat</p>	<p>Çështja 4 - Mos inkasimi i të hyrave nga Bizneset jo-aktive -Prioritet i Lartë Drejtori i Përgjithshëm përveç që ka siguruar të dhëna adekuate për bizneset jo aktive duhet të shqyrtoj edhe mekanizmat ligjorë për grumbullimin e të hyrave nga këto biznese.</p> <p>Çështja 5 - Mos harmonizim i të dhënave për rimbursimet mes Thesarit dhe ATK-së - Prioritet i Lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj masat për identifikimin e shkaktarëve për të dhënat jo konsistente dhe eliminimin e tyre në mënyrë që të sigurohet harmonizimi I të dhënave lidhur me rimbursimet.</p> <p>Çështja 6-Vonesa në rishqyrtimin e rimbursimeve - Prioritet i mesëm Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që kërkesa e tatimpaguesve të aprovuara për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor.</p>		<p>Pjesërisht</p>	<p>Jo</p> <p>Jo</p>
<p>4.3 Shpenzimet 4.3.1 Prokurimi</p>	<p>Çështja 7 - Zgjatja e kontratës publike kornizë përtej afatit ligjor - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që kontratat publike korniz nuk janë zgjatur përtej afatit ligjor.</p>	<p>Po</p>		

	<p>Çështja 8 - Mangësi në procesin e prokurimit – Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka shtuar kujdesin para nënshkrimit të kontratës për të siguruar operator të përgjegjshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, me rastin e nënshkrimit të kontratës me OE paraprakisht të siguroj se është depozituar siguria e ekzekutimit e barabartë apo jo më pak se 10% e vlerës së kontratës.</p> <p>Çështja 9 - Shpenzimet e telefonisë mobile pa procedurë të prokurimit publik – Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhur me shërbimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme.</p> <p>Çështja 10- Përfshirja e shpenzimeve komunale në ‘Plan të Prokurimit’ – Prioritet i mesëm Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj vetëdijesim dhe monitorim të mjaftueshëm në përgatitjen e planit të prokurimit.</p> <p>Çështja 11 - Vonesë në liferimin e mallrave nga operatorët ekonomik – Prioritet i Mesëm Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që kontrollet e monitorimit janë vendosur për të siguruar që shërbimet apo furnizimet nga OE të përzgjedhur të realizohen brenda afatit kohorë të përcaktuar sipas kontratës.</p>	<p>Po</p> <p>Po</p> <p>Po</p> <p>Po</p>		
--	--	---	--	--

<p>4.3.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)</p>	<p>Çështja 12 - Mospërputhje në mes të koeficientit në akt emërim me koeficientin në payroll - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që paraprakisht ka marr aprovimet e duhura nga autoritet përkatëse për ngritje të pagave dhe më pas t'i reflektoj ndryshimet në aktë emërim.</p> <p>Çështja 13- Mungon përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi - Prioritet i mesëm Drejtori i Përgjithshëm duhet të inicioj procedurat për sigurimin e përshkrimeve të qarta të detyrave dhe përgjegjësi në Aktin e emërimit.</p>	<p>Po</p>		<p>Jo</p>
<p>4.4 Pasuritë dhe detyrimet 4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale</p>	<p>Çështja 14 - Mangësi në Menaxhimin e Pasurive të ATK-së - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqepërdorimi.</p>			<p>Jo</p>
<p>4.4.2 Detyrimet e papaguara</p>	<p>Çështja 15 - Rritja e obligimeve dhe mangësi në raportimin e tyre në Thesar - Prioritet i mesëm Drejtori i Përgjithshëm duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që faturat e papaguara të paguhen me kohë me qëllim që obligimet të mos ngarkojn buxhetin e vitit vijues. Veç kësaj, në raporte mujore të obligimeve të prezantohen (raportohen) datat e krijimit të obligimit.</p>	<p>Po</p>		

<p>4.4.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve</p>	<p>Çështja 16 – Të hyrat e pa arkëtuara - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshme. Të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë veprimet ligjore. Gjithashtu të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve.</p>			<p>Jo</p>
<p>4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm</p>	<p>Çështja 17 - Njësia e auditimit nuk e kishte realizuar planin për vitin 2014 - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të punojë me Drejtorin e NjAB-së për të siguruar përmbushjen e planit. Plani i NjAB-së duhet të monitorohet në baza mujore dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.</p>	<p>Po</p>		